



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 8 tetor 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Urdhër drejtuar Mbrojtjes për Paraqitjen e Parashtrimeve mbi Afatin për
Rishikimin e Ardhshëm të Paraburgimit**

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit

Gregori Kihou

Mbrojtësit të Viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtësit të Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit

Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në përputhje me nenin 39(13) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, nxjerr këtë urdhër.

1. Më 25 qershor 2021 dhe 2 korrik 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Jakup Krasniqit,² Rexhep Selimit³ dhe Kadri Veselit⁴ (“Vendimet mbi Paraburgimin” dhe “z. Krasniqi”, “z. Selimi” dhe “z. Veseli”, bashkërisht “të akuzuarit”).
2. Më 7, 8, dhe 15 korrik 2021, Mbrojtja e z. Krasniqi,⁵ Mbrojtja e z. Selimi⁶ dhe Mbrojtja e z. Veseli⁷ (bashkërisht “Mbrojtja”) apeluan Vendimet përkatëse mbi Paraburgimin.
3. Më 21 korrik, 26 korrik dhe 10 gusht 2021, në vijim të kërkesës së Mbrojtjes,⁸ Gjykatësi i Procedurës Paraprake ndryshoi afatin e Mbrojtjes për paraqitjen e

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00371, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Jakup Krasniqit*, 25 qershor 2021, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 30 qershor 2021, F00371/RED.

³ KSC-BC-2020-06, F00372, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Rexhep Selimit*, 25 qershor 2021, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 30 qershor 2021, F00372/RED.

⁴ KSC-BC-2020-06, F00380, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Kadri Veselit*, 2 korrik 2021, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua të njëjtën ditë, F00380/RED.

⁵ KSC-BC-2020-06, IA006/F00001, Mbrojtja e z. Krasniqi, *Apel i Mbrojtjes së Krasniqit kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Jakup Krasniqit*, 7 korrik 2021, konfidencial, me Shtojcën 1, publike. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 5 tetor 2021, IA006/F00001/RED.

⁶ KSC-BC-2020-06, IA007/F00001, Mbrojtja e z. Selimi, *Apel kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Rexhep Selimit*, 8 korrik 2021, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 25 gusht 2021, IA007/F00001/RED.

⁷ KSC-BC-2020-06, IA008/F00001, Mbrojtja e z. Veseli, *Apel i Mbrojtjes së Veselit ndaj Vendimit KSC-BC-2020-06/F00380 (Rishikimi i Parë i Paraburgimit)*, 15 korrik 2021, konfidencial, me Shtojcat 1-2, konfidenciale.

⁸ KSC-BC-2020-06, Transkript i seancës, 21 korrik 2021, publik, f. 532, rreshti 10 deri në f. 533, rreshti 15; F00415, Mbrojtja e z. Selimi, *Kërkesë e Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit për Paraqitjen e Parashtrimeve mbi Rishikimin e Paraburgimit*, 23 korrik 2021, publike; F00429, Mbrojtja e z. Veseli, *Kërkesë e Mbrojtjes së Veselit lidhur me Rishikimin e Dytë të Paraburgimit*, 9 gusht 2021, publike.

parashtrimeve të tyre nëse ekzistonin ende arsytet për vazhdimin e paraburgimit dhe urdhëroi që këto parashtrime të dorëzoheshin jo më vonë se dhjetë ditë pas njoftimit të vendimeve të pritshme të Panelit të Gjykatës së Apelit mbi apelet.⁹

4. Më 1 tetor 2021, Paneli i Gjykatës së Apelit nxori vendimet e veta në të cilat miratoi pjesërisht apelet e Mbrojtjes dhe i ktheu Gjykatësit të Procedurës Paraprake për rishqyrtim pikën nëse Policia e Kosovës mund të zbatonte efektivisht masat e propozuara prej Mbrojtjes apo çdo masë tjetër që Gjykatësi i Procedurës Paraprake e gjykon të domosdoshme.¹⁰

5. Më 8 tetor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i drejtoi Policisë së Kosovës urdhër për dorëzimin e informacionit lidhur me autoritetin dhe kapacitetin e saj për zbatimin e kushteve në lidhje me lirimin e përkohshëm, sikurse specifikohet në urdhër.¹¹

6. Duke marrë parasysh sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i kërkon Mbrojtjes të paraqesë parashtrime nëse parapëlqen:

(a) kryerjen e rishikimit të paraburgimit të të akuzuarve në bazë të kalendarit të përcaktuar më parë nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, siç përmendet në paragrafin 3 më lart;

⁹ KSC-BC-2020-06, Transkript i seancës, 21 korrik 2021, publik, f. 536, rreshtat 10-23; F00419, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Selimit për Zgjatjen e Afatit*, 26 korrik 2021, publik; F00430, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Veselit për Zgjatjen e Afatit*, 10 gusht 2021, publik.

¹⁰ KSC-BC-2020-06, IA006/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Jakup Krasniqit kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit*, 1 tetor 2021, konfidencial, para. 58, 60; IA007/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit*, 1 tetor 2021, konfidencial, para. 58-59; IA008/F00004, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit*, 1 tetor 2021, konfidencial, para. 53-54. Versionet e redaktuara publike u dorëzuan të njëjtën ditë, IA006/F00005/RED, IA007/F00005/RED dhe IA008/F00004/RED.

¹¹ KSC-BC-2020-06, F00513, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër Drejtuar Policisë së Kosovës për Dorëzim Informacioni*, 8 tetor 2021, publik, me një shtojcë konfidenciale.

- (b) kryerjen e rishikimit të paraburgimit të të akuzuarve njëkohësisht me rishqyrtimin e Vendimeve mbi Paraburgimin nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake duke mbajtur parasysh udhëzimet e Panelit të Gjykatës së Apelit, në një vendim të vetëm përmbledhës. Në këtë rast, mbetet në fuqi kalendari i përmendur në paragrafin 3. Gjithashtu, në qoftë se palët dëshirojnë të paraqesin parashtrime lidhur me parashtrimet e Policisë së Kosovës, atëherë Prokurori i Specializuar duhet t'i dorëzojë këto parashtrime brenda pesë ditësh nga marrja e njoftimit për përkthimin në anglisht të parashtrimeve në fjalë, ndërsa Mbrojtja brenda tri ditësh nga marrja e njoftimit për parashtrimet e Prokurorit të Specializuar; ose
- (c) shtyrjen e rishikimit të ardhshëm të masës së paraburgimit deri në dy muaj pasi Gjykatësi i Procedurës Paraprake të ketë rishqyrtuar Vendimet mbi Paraburgimin, në të cilin rast kalendar i ri për dorëzimin e parashtrimeve do të përcaktohet në vendimet e ardhshme mbi paraburgimin. Në qoftë se Mbrojtja parapëlqen këtë alternativë, atëherë duhet të konfirmojë se gjatë periudhës së ndërkohshme, të akuzuarit heqin dorë nga e drejta e tyre për rishikimin e masës së paraburgimit brenda afatit dymujor.¹²
7. Për këto arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:
- URDHËRON** Mbrojtjen të paraqesë parashtrime, sikurse përcaktohet në paragrafin 6 të këtij urdhri, jo më vonë se **të mërkurën, 13 tetor 2021**.

/nënshkrimi/

¹² *Shih po ashtu, KSC-BC-2020-06, F00415, Mbrojtja e z. Selimi, Kërkesë e Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit për Paraqitjen e Parashtrimeve mbi Rishikimin e Paraburgimit, 23 korrik 2021, publike, para. 4; F00429, Mbrojtja e z. Veseli, Kërkesë e Mbrojtjes së Veselit lidhur me Rishikimin e Dytë të Paraburgimit, 9 gusht 2021, publike, para. 2.*

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatësi i Procedurës Paraprake

E premte, 8 tetor 2021
Në Hagë, Holandë